



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 22-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 27. 10. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic, anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
2. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-se

3. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
4. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
5. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shendetesise
6. Feti Krasniqi, Drejtor i BPZHR
7. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
8. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
9. Vlora Krasniqi, shefe e zyres ligjore
10. Ahmet Maksuti , zyra ligjore
11. Sanije Haziri, përfaqësuese e OSBE-së
12. Bekim Krasniqi, "YAHR"
13. Bukurije Zejnullahu, zyra për informim
14. Përfaqësuesit e mediave
15. Numër i konsideruar i qytetarëve
16. Naser Bytyqi, perkthyes shqip-serbisht
17. Rifat Hoxha,
18. Bajram Zaskoku
19. KFORI Turk

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti Sami Murati.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 26 anëtarë nga gjithsej 31 tha se ekziston kurorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë të cilin e lexoi në vazhdim dhe pastaj të njejtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të e KK-së
2. Raporti nëntëmujor i shpenzimeve të buxhetit dhe të hyrat për vitin 2015
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit Orijentues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016
4. Propozim Vendim për miratimin e raportit të punës të Komisionit për qështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit
5. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të Komunës.
6. Propozim Vendim për anulimin e vendimit për ndarjen-transferimin e mjeteve financiare 15Nr.400-11527 i datës 03.03.2015
7. Informatë e Drejtoratit për Arsim
8. Informatë e DBPZHR lidhur me fushatën e korrje shirjeve për vitin 2015 në Komunën e Lipjanit si dhe përgaditjet e mbjelljeve vjeshtore

Para se të kalohet në punë sipas pikës së parë, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuhi pyeti anëtarët se a ka dikush të shtroj pyetje.

Florent Hoxha, tha se qytetarët e Gadimes i janë drejtuar me shkrim Drejtoratit për Shërbime Publike për shtruarje e rrugës së Lumit në Gadime e cila ka qenë e paraparë me buxhet e që e njëjta pa paralajmërim është hjekë nga buxheti.

Pastaj tha se kjo rrugë gjatë rregullimit të kanalizimit është dëmtuar shumë.

Shqetësim tjetër është rruga te “Abea “ e cila është e vetmja rrugë që nuk është shtruar, andaj kërkoj që kjo rrugë mbrenda këtij viti të shtrohet.

Te rruga 4 korsi në qytet që ne edhe më herët kemi kërku që gabimet që janë bërë të përmirësohen dhe aty ka fillu përmirësimi por dashta të pyes se kubzat që po hiqen ku janë duke shkuar.

Ramiz Qeriqi, unë kam kërkesën e Krojmirrit që rruga e cila është ndërtu te shkolla uji hynë nga rruga në oborrin e shkollës dhe pyes se si ka mund të pranohet teknikisht ajo rrugë dhe duhet të bëhet një zgjidhje për eliminimin e atij uji.

Burbuqe Ilazi, në disa rrugë në Lipjan janë vjedh kapakët e pusetave dhe po paraqesin rrezik për qytetarët, andaj kërkoj nga Drejtorati i Shërbimeve Publike që të intervenon në rregullimin e tyre e që është kërkesë edhe e qytetarëve të Lipjanit.

Arben Bahtiri, kërkoj që të ndërmerret diçka për zgjidhjen e problemit për qenët endacak si dhe qështja e legalizimit të objekteve të na njoftoj Drejtori i DPU-se deri ku ka arritë ky proces e gjithashtu në qdo stacion të autobusave të vëhet itinerari i autobusëve.

Petrit Kelmendi, paraqiti shqetësimin e lagjës së Troshupëve e cila gjendet në mes të Lipjanit dhe Rucit të Ri ku kërkojnë zhavorimin e kësaj rruge që lidhet me rrugën e tranzitit si dhe ndërtimin e urës te Lumi Janjevës.

Nehat Tërpeza, edhe unë po paraqes shqetësimin e qytetarëve të fshatit Zllakuqan ku kërkojnë zhavorimin e rrugës së fshatit deri te shkolla si dhe zhavorimin e rrugëve në fshatin Ribar i Madh të cilat kanë mbetur pa asfaltu e posaqërisht rrugët në lagjen Rama, Grajçevci dhe Kozhanve.

Zoran Çirkoviq, unë kam dy kërkesa e para asfaltimi i rrugës te shkolla fillore “Braça Aksiq” e cila është një gjatësi vetëm 100 metra dhe kërkoj që mundësisht kjo rrugë të asfaltohet në këtë vit apo vitin e ardhshëm, gjithashtu tha se para një muaji kjo shkollë është gjujtë me gurë dhe është kërkesë e prindërve që mundësisht të vendosen video kamera në shkollë e gjithashtu edhe në oborrin e Kishes ortodokse.

Kërkesa e dytë është për fshatin Grackë e Vjetër ku objekti i ish Kooperativës bujqësore është blerë nga një person dhe i ka dhënë dikujt tjetër në shfrytëzim dhe aty është duke u punuar diçka por askush nuk e di se çka punohet, andaj është mirë që inspekcioni apo të formohet një komision dhe të shiqon se çka është duke u punuar aty.

Naim Jahiri, kërkoj që te lagja e muhaxherve në Smallushë të zhavorohet rruga e gjithashtu kërkoj që shefi i grupit parlamentar Florent Hoxha të vijë në fshatin Sillovi dhe të shoh se me 37 mijë euro është bërë shtrurja e rrugës, rregullimi i shtratit të Lumit dhe ndërtimi i urës, këtë po e kërkoj meqë më herët ka thënë se me 50 mijë euro nuk mund të rregullohet këto punë.

Ilir Tasholli, e pash të arsyeshme të flas lidhur me kërkesën që paraqiti Florenti meqë unë e kam parë këtë kërkesë dhe ata që e kanë nënshkru këtë kërkesë nuk kanë shtëpia fare në atë rrugë por janë ara. Unë jam i Gadimes dhe na i kemi parapa rrugët për asfaltim në Gadime që gjithsej janë 9 kilometra. Sa i përket rrugës te Abea besoj se në vitin e ardhshëm kjo rrugë do të asfaltohet. Sa i përket legalizimit të objekteve ky është proces nacional dhe na e kemi kry fazën e parë ku kemi bërë regjistrimin e objekteve dhe ky proces do të vazhdoj me faza dhe sigurisht do të zgjas edhe dy vite.

Ramiz Qeriqi, rruga Qamil Olluri ka më së shumti banor por ose i kini inati që ka emërin e dëshmorit ose pse në atë lagje jetojnë më shumë drenicak për këtë nuk është shtruar.

Pasi pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të Kuvendit?

Florent Hoxha, unë po e ngriti një shqetësimin personal lidhur me ekstraktin ku në mbledhjen e kaluar kam shpreh shqetësimin tim dhe shqetësimin e grupit parlamentar të PDK-së dhe i kam propozu këtij Kuvendi për planifikimin e buxhetit kurse në ekstrakt janë përfshi 2-3 fjali dhe në fund të fjalisë thuhet se është përgatit fjala me shkrim a unë nuk paraqitë fjalë me shkrim. Unë e di se të gjitha nuk mund të përfshihen të gjitha diskutimet por ato qka janë me rëndësi duhet të përfshihen, andaj kërkoj që procesmbajtësi në bazë të inqizimit ta plotëson këtë ekstrakt.

Vlora Limani-Hajnuni, pa dashtë të lëshohem në diskutimet për ekstraktin ju them se neni 30 i Statutit të Komunës dhe neni 24 i Rregullores së Punës së Kuvendit e parasheh të jkartë se qka duhet të përmbaj procesverbali.

Pastaj vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për 7 kundër

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raporti nëntëmujor i shpenzimeve të buxhetit dhe të hyrat për vitin 2015

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF- i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i cili sajon pjesën përbërëse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, në këtë raport të shpenzimeve unë nuk e kam materialin për shpenzimet e investimeve kapitale nuk e di të tjerëve a u është shpërnda ky material apo vetëm u prezantu dhe do të ishte mirë që Drejtori i Shërbimeve Publike të na njoftoj se në cilën fazë të implementimit janë projektet.

Te mallërat dhe shërbimet dashta të pyes për shpenzimet e derivateve mirëmbajtjen e automjeteve, shpanzimet e udhëtimit etj. Gjithashtu është mirë me ditë se kush janë përfitueset e subvencioneve.

Agron Hajdini, ky vit në vazhdimësi ka kontinuitet në shpenzimin e buxhetit dhe buxheti është shpenzu për këtë periudhë 84% dhe deri në fund të vitit buxheti i planifikuar sigurisht se do të realizohet. Në vitin e kaluar Komuna e jonë është shpallë Komuna më e mirë në realizimin e buxhetit. Te taksat për lejet e ndërtimit si dhe shërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore planifikimi është tejkalu. Te investimet kapitale deri në fund të vitit besoj se do të arrijmë të shpenzojmë të gjitha mjetet e planifikuara dhe për këtë përgëzoj ekzekutivin.

Florlent Hoxha, na si grup parlamentar i PDK-së e kem shqyrtu këtë raport të shpenzimeve dhe sipas këtij materiali shihen vetëm kodet e fondeve burimore dhe nuk dihet se si kanë ndodh shpenzimet. Buxheti thuhet se është realizu me 84% por në shumë kategori shihet se realizimi nuk është në nivel. Te mallërat dhe shërbimet realizimi është 56% te subvencionet 77%, te investimet kapitale 64%, te komunalitë 59% kurse te pagat dhe meditet nuk i përmenda se këto nuk udhëhiqen nga ne realizimi është 100% i cili rritë

shkallën e realizimit të buxhetit të tërsishëm qka do thot se nëse hiqet realizimi nga pagat ky buxhet nuk e kalon realizimin 60%. Te investimet kapitale te disa projekte, sipas këtij raporti të cilat i ceku edhe Drejtori shpenzimi është 0,0 dhe shembull te rruga e Baicës për këtë vit janë parapa 55 mijë euro kurse janë shpenzu vetëm 25 mijë euro qka do të thot se kanë mbetë 30 mijë euro dhe këto mjete ekzekutivi do t'i ridestinoj e pastaj do të planifikoj për shpenzimet në projekte të reja në mënyrë që të dal para opinionit dhe thotë se unë po realizoj 500-1000 projekte a disa projekte në vazhdimësi kanë mbetë pa u realizu.

Ali Stublla, rreth taksave që përmendi Agroni për lejet e ndërtimit se është tejkalu planifikim dhe konsideroj se ky sukses u takon qytetarëve të cilën kanë pasur mjete për të ndërtu dhe suksesi nuk i takon komunës.

Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së tha se disa komuna nuk raportojnë fare për 9 mujorë.

Ky raport është paraqitë në vija të trasha dhe nëse ju kërkoni unë mund të përgatiti raportin me 1000 faqe por kjo është ngarkesë për juve. Ky raport është mjaft detal dhe paraqet detalisht shpenzimet sipas granteve dhe duhet të dini se keni përgjegjësi dhe mos dezinformoni opinionin.

U përmend rruga e Baicës dhe na nuk mund të përzihemi në procedura të cilat i zbaton Drejtoria e prokurimit.

Florent Hoxha, e ceku Drejtori se planifikimi që ka ndodh dhe kontrata që është lidhur me operatorin na nuk mundemi me e diku e gjithashtu e tha se ka bërë thirrje organizatave jo qeveritare dhe qytetarëve që të marrin pjesë gjatë procedimit të prokurimit në hapje të ofertave dhe me vlerësim por duhet ta dimë se hapja dhe vlerësime janë dy qështje që dallojnë se hapja mund të jetë publike kurse vlerësimi duhet të shiqohet se a është e parapame që këto OJQ të marrin pjesë. Unë e kam edhe kontratën që sot nuk e kam sjellë këtu të cilën e keni nënshkruar ju që hapja ka qenë 4 mijë euro kurse kontratën e keni nënshkru me 7 mijë euro dhe si shembull po e marr nëse një projekt ka qenë planifikimi 50 mijë euro kurse kontrata është nënshkru me 20 mijë dallimi është 30 mijë euro qka do të thot që diqka nuk është në rregull dhe planifikimi është bërë shabllon.

Shkelzen Hajdini, është me rëndësi të madhe që buxheti të menaxhohet mirë se na kemi gjetë 7 milion euro borxh. Unë ju thrras që të bëni analizë se sa ka kushtu një metër asfalt me juve kur keni qenë në pushtet e sa është tani me neve.

Blerim Gashi, unë konsideroj se si anëtarë të Kuvendit kemi të drejtë me kërkua dhe me u njoftu me shpenzimet e buxhetit e gjithashtu me ditë se ku po investohen këto mjete dhe në cilat projekte dhe cilat rrugë.

Shpenzimi i buxhetit është i mirë dhe deri në fund të vitit do të realizohet me 100%.

Është me rëndësi të madhe që të realizohen mjetet nga grantet qeveritare meqë nëse nuk realizohen atëherë shkojnë në suficit.

Nazmi Krasniqi, Drejtori e tha se nuk e ka obligim ligjor me e paraqitë këtë raport në Kuvend dhe nëse nuk e ka obligim atëherë pse e paraqet. Për mua me rëndësi të madhe është se si po kryhen punët në teren se shembull po e marr në Torinë menjëherë pas përfundimit të rrugës është prishë asfalti në një vend dhe është hapë një gropë, gjithashtu është investu në kontinjerët nëntoksorë dhe nuk janë funksional.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike u kalua në pikën e tretë.

III

Propozim Vendim per miratimin e Planit Orijentues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, tha se këtë plan e kemi shqyrtuar edhe në KPF dhe nga propozimet që janë dhënë aty është nxjerrë një rekomandim që ky plan të plotësohet me pikat si vijon:

- Në janar të parashihet plani i punës së auditorit dhe plani i punës së Drejtoratit të prokurimit.

- Në muajin mars informatë për kriteret, kushtet dhe procedurat dhe numrin e aplikuesve për grante dhe subvencione në bujqësi.

- Në muajin tetor për korrije shirjet për vitin 2016 dhe plani i të mbjellurave për vitin 2016-2018.

- Në korrik informatë nga DKA-ja për përmbylljen e vitit shkollor.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë plan orientues e gjithashtu dëgjuam edhe rekomandimet e KPF-së për plotësim të këtij plani dhe e përkrahim këtë plan.

Nazmi Krasniqi, unë në KPF kam propozu që raporti për arsimin të shqyrtohet në janar e gjithashtu në korrik dhe shtator.

Vlora Limani-Hajnuni, këtë plan e kemi hartu në bashkëpunim me shefat e grupeve parlamentare dhe informatën e arsimit e kemi parapa për shqyrtim në shkurt dhe shtator.

Xhevat Olluri, në KPF unë kam dhënë propozimin që në këtë plan të hyn shqyrtimi i planit të punës së auditorit dhe plani i punës së prokurimit.

Blerim Gashi, unë kërkoj që planet e punës të shqyrtohen në nëntor apo dhjetor të këtij viti.

Arben Bahtiri, në KPF kam kërku që në dhjetor të shqyrtohet një informatë për Kulturë, Rini dhe Sport, për sukseset dhe vështirësitë që janë në këtë lëmi.

Florent Hoxha, me nenin 52 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale parasheh që plani i punës së auditorit dhe plani i punës së prokurimit të shqyrtohen vetëm në KPF por jo edhe në Kuvend.

Meqë propozime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim planin orientues të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016 së bashku me propozimet për plotësim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, 1 kundër, apstenim nuk pati

Aprovoi

Planin Orijentues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016

Shtesë: Plani.

Pas përfundimit të kësaj pike Kryesuesja dha pauzë deri në ora 13,10

Pas pauzës në ora 13,15 kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katërt

IV

Propozim Vendim për miratimin e raportit të punës të Komisionit për qështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Daut Azemit Kryetar i Komisionit i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me përbërjen e Komisionit i formuar nga Kuvendi i Komunës si dhe ndryshimet e Komisionit të cilat janë bërë pastaj.

Në vazhdim njoftoi lidhur me procedurat për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave si dhe me bashkëpunimin që kanë pasur me organizatën DEMOS të Zvicrrës si dhe ndihmen që ka dhënë kjo organizatë komisionit për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve.

Pastaj njoftoi Kuvendin me strukturën e anëtarëve të zgjedhur në Këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës. Pastaj përmendi rastin e lagjës së re dhe Rubovcit të Hashanve që këtu nuk janë përfshi në zgjedhje për shkak se nuk janë si fshatra të parapara në Statutin e Komunës.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, falenderoj Komisionin për punën që ka bërë për këto zgjedhje dhe na grupi parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë raport.

Enver Kozhani, na si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu këtë raport dhe kemi konstatu se ka mangësi. Në këto zgjedhje nuk është përfshi fare Jeta e Re. Në lokalitetin prej nga vij unë në zgjedhje kanë prezantuar vetë 24 qytetarë a dihet se me të drejtë vote për zgjedhje janë mbë 300 qytetar dhe shtrohet pyetja se qfarë zgjedhje janë këto kur shumica nuk kanë marrë pjesë.

Ali Stublla, unë edhe më herët kam kërku për mbajtjen e zgjedhjeve në lagjen Jeta e Re por edhe për kundër kësaj kërkesë aty nuk janë mbajtur zgjedhje.

Ramiz Qeriqi, në komision nuk janë përfshi të gjitha subjektet politike.

Naim Jahiri. Unë kam qenë në mbledhje në Sillovi dhe kanë marrë pjesë shumë qytetarë në zgjedhje dhe zgjedhjet kanë qenë në rregull kurse në fshatra tjera nuk e di si kanë qenë.

Linda Shahini, u tha se zgjedhjet janë bojkotu nga subjekt i PDK-së, por në Magurë për Kryetar ka konkuru Sadik Dulla e që njëherit është edhe Kryetar i PDK-së mirëpo nuk ka fitu për Kryetar të fshatit.

Florent Hoxha, vërejtjet dhe shqetësimet i paraqiti edhe parafolësi në emër të PDK-së dhe na si PDK me kohë kemi deklaruar se i bojkotojmë këto zgjedhje, ndërsa sa i përket zgjedhjet në Magurë ku Linda përmendi se për Kryetar ka konkuru Kryetari i nëndegës së PDK-së Sadik Dulla dhe ju njoftoj se Sadik Dulla nuk është Kryetar i PDK-së në Magurë dhe si individ ka mund me konkuru. Këto zgjedhje kanë pasur mangësi ku Kryetari i Këshillit të fshatit është zgjedh me 20 vota kurse kur ne i kemi pasur zgjedhjet për Këshilla të fshatrave Kryetarët e fshatrave janë zgjedh me mbi 200 vetë. Në komision është e vërtetë se kemi leju që të marrin pjesë dy anëtarë nga PDK-ja dhe këtë e kemi bërë vetëm për të caktuar datat e zgjedhjeve dhe për të shiqu se si po shkon procesi i zgjedhjeve. Në vazhdim tha se nuk e di se a është prezent përfaqësuesi i shoqatës HEVITAS që e ka përkrah dhe mbështet Komisionin që e falenderoj shumë për këtë dhe dashta ta pyes se a është e njoftuar kjo shoqatë se ata që kanë shpërnda afishe a kanë qenë të të gjitha subjekteve apo vetëm të subjektit të LDK-së dhe kryesisht politik që i ka zgjedh LDK-ja. Në Shalë është zgjedh Kryetari dhe pavarësisht bojkotit, unë e njoh për Kryetar, por jo vetëm në këtë fshat por edhe në fshatra tjera janë zgjedhur njerëzit që nuk kanë autoritet dhe nuk mund t'i bartin përgjegjësit konform Rregullores që i kanë të përcaktuar. Unë nuk e di se si edhe organizata HLEVITAS ka ndar mirënjohje për këtë proces të zgjedhjeve.

Nazmi Krasniqi, në Smallushë zgjedhjet janë mbajtur me një orë vones dhe nuk kanë qenë në rregull.

Daut Azemi, unë e thash se Komisioni ka qenë komplet dhe është zgjedh në Kuvend. Rregullorja është aprovu në Kuvend dhe na kemi punuar në bazë të Rregullores. Sa i përket zgjedhjeve për Jetën e Re dhe Rubovci unë i arsyetova më herët pse nuk janë mbajtur zgjedhjet. Sa i përket PDK-së na në qdo vend ku kemi shku propozimet i kemi marr prej qytetarëve e jo prej subjekteve politika. Votimet kanë shku ashtu si kanë dashtë me vendos me vota të mshefta apo me vota të hapura.

Në Ribar kanë qenë mbi 30 votues prezent në zgjedhje.

Materialet për procesin e zgjedhjeve i janë dorëzu sektorit të Kuvendit dhe kujt i intereson mundet me i pa. Florenti e tha se Kryetarët e zgjedhur janë pa autoritet dhe unë ju them se ata Kryetar i kanë zgjedh qytetarët.

Përfaqësuesi i DEMOSIT ka qenë Adelina Krasniqi nga Peja.

Te rasti i Smallushës ju njoftoj se kemi pasur 2 termine në ora 17,⁰⁰ dhe në ora 20,⁰⁰ dhe është e vërtetë se kemi prit pak por nuk e di se ka pas paknaqësi.

Florent Hoxha, unë e ngrita një shqetësim tonin ku pjesëmarrja në shoqatë HEVITAS kanë qenë mbi 15 që kanë shpërnda afishe dhe kryesisht kanë qenë të LDK-së që ju i keni zgjedhur.

Ramiz Qeriqi, ne po bojmë pyetje dhe kuptoni se jo për inati por ju them se jo në lagjen tonë na nuk kemi qenë të informuar për këto zgjedhje.

Daut Azemi, na kemi informu edhe përmes Webfaqës së Komunës edhe përmes reklamave që kemi vendos para banesave kurse DEMOSI në mënyrë të veçant i ka informuar qytetarët. Në KPF ka pasur pyetje pse nuk janë zgjedhur femra për Kryetare të fshatit ju njoftoj se 3 femra janë propozu por nuk i kanë fituar votat.

Vlora Limani-Hajnuhi, bojkoti i PDK-se ka ndadhur për shkak të ndryshimit të Rregullores dhe ky ndryshim është bërë me kërkesë të MAPL-së meqë me Rregulloren e mëparshme këto zgjedhje kanë qenë si zgjedhje e nivelit të tretë e që me Kushtetutë dhe me Ligj nuk kemi zgjedhje të nivelit të tretë.

Pastaj vuri në votim propozimin e Vendimit për miratimin e raportit të punës të Komisionit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për, 6 kundër, 2 apstenime aprovoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE TË FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET , Raporti i punës i Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit për organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokaliteteve në territorin e Komunës së Lipjanit .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Punës i Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit i datës 15.09.2015.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendim.

V

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Linda Shahini, ne si grup parlamentar i LDK-se e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe të njejtin e përkrahim.

Florent Hoxha, na disa herë kemi ngrit shqetësimin tonë që në këto komisione të jenë me të vërtetë anëtar nga organizatat jo qeveritare e jo nga subjektet politike dhe pyes se në qfar mënyre është zgjedh Flakadan Osmani se edhe ky është sikur Burim Rrustemi që ka qenë i LDK-së.

Avni Olluri, na e kemi publiku konkursin që në komision të dërgohet një anëtarë nga shoqërit civile dhe kjo organizatë e ka dërgu Flakadan Osmanin.

Florent Hoxha, unë e kam lexu në fejbuk se organizata ka dërguar një emër të kandidatit tjetër por nuk është zgjedh ai po Flakadan Osmani në LDK.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për 10 kundër miratoi këtë:

VENDIM PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim **zëvendësohet** anëtari i Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Burim Rrustemi nga shoqëria civile – OJQ “Jeta Rinore” i emëruar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.464-13205 të datës 31.03.2014, dhe në vend të tij caktohet **FLAKADON OSMANI** nga Organizata joqeveritare PLOT (Progress is Link with Operation and Time) sipas kërkesës së OJQ-së së cekur 15Nr-031-30271 të datës 25.06.2015.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i anëtarëve të komisionit është i përcaktuar me dispozitat e Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.464-13205 të datës 31.03.2014

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendim për anulimin e vendimit për ndarjen-transferimin e mjeteve financiare 15Nr.400-11527 i datës 03.03.2015

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Remzi Mehmetit Drejtor i DMSH-së, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit si dhe arsyeshmërin e anulimit të këtij Vendimi. Në vazhdim njoftoi se nesër do të niset nga Anglia një kamion me të gjitha paisjet dhe shpenzimet e transportit do të kushtojnë rreth 1550 euro.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, unë po lidhem me anulimin e këtij Vendimi dhe si arsye e anulimit të këtij Vendimi është për shkak se operatori ka qenë i pa përgjegjshëm dhe Drejtori na njoftoj se

nesër do të niset një tjetër kamion nga Anglia, andaj është mirë që po anulohet vendimi i parë në mënyrë mos të na sjell telashe tjera.

Daut Azemi, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtuar këtë propozim Vendim dhe e përkrahim në tërësi.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstato se Kuvendi me 24 vota për, asnjë kundër, aprovoi këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT PËR NDARJEN-TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE 15NR.400-11527 I DATËS 03.03.2015

- I. ANULOHET,** Vendimi i Kuvendit të Komunës për ndarjen-transferimin e mjeteve financiare 15Nr.400-11527 i datës 03.03.2015.
- II. I TËRHIQET,** Kryetari të Komunës dhënia e Pëlqimit për ndarjen- transferimin e mjeteve financiare në shumë prej 3000 € (tremijë) euro, në xhirollogarinë bankare të Salih Jakupit (person i autorizuar nga Komuna) i cili do ti kryej të gjitha shërbimet dhe pagesat për transportimin e automjetit-kamionit të zjarrëfikjes “ Mercedes” 608D nga qyteti Sinsheim i Gjermanisë në qytetin e Lipjanit, sipas Kërkesës së Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim- Njësisë së zjarrëfikjes dhe Shpëtim në Lipjan.
- III.** Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFagen e Komunës

Shtesë: Vendimi.

VII

Informatë e Drejtoratit për Arsim

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Rasim Hasanit Drejtor i DKA-së i cili në vazhdim tha se në raportin e :Kryetari ka qenë edhe raporti i DKA-se por me kërkesën e juve kam paraqit këtë informatë e që në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, falenderoj Drejtorin me paraqitjen e kësaj informate ku nga kjo informatë, por edhe qdo ditë e shohim se gjendja në shkolla është përmirësuar dukshëm. Sot të gjitha shkollat kanë qasje në internet dhe në dy shkolla kemi edhe video monitorim. Një qështje me prioritet nga DKA-ja është qështje e trajnimeve të personelit arsimor, pastaj transporti i nxënësve nëpër fshatra ku është i nevojshëm. Po ashtu qështja e pagave të punëtorëve arsimor ku asnjë punëtorë arsimor nuk mbetet pa u paguar.

Florent Hoxha, në KPF kemi kërkuar një informatë nga DKA-ja edhe më herët, po tash po e përsërisim edhe një herë e posaqërisht qështjen e pranimit të kuadrit mësimor si dhe suksesin e nxënësve. Kemi të dhëna se tërë ky proces është zhvilluar duke rehatuar militantët partiak të kualicionit qeverisës pa asnjë kriter profesional, po ashtu mbyllja e shkollës në Qendrën korrektuese. Gjatë shpalljes së konkursit ka pasur shkelje ligjore duke ruajtur vende pune për militantët partiak e posaqërisht për lëndën e muzikës dhe lëndëve

tjera mësimore të cilat konsiderohen për plotësim norme. Pastaj përmendi disa shkelje nëpër shkolla të Komunës së Lipjanit.

Ramiz Qirriqi, në shkollën e gjimnazit kam dy vërejtje: e para ka të bëjë me veshjen e arsimtarëve të cilët nuk krijojnë përshtypje të arsimtarit; e dyta është që si punëtore teknike të pranohen femra e jo meshkuj.

Nazmi Krasniqi, më habit informata edhe pse është mjaft voluminoze me letra por edhe diskutimi i Nehatit i cili përmend vetëm disa rrethoja dhe laminate. Askund nuk përmendet MASHTI i cili bënë trajnimet e stafit mësimor. Askund nuk përmendet suksesi i nxënësve as specifikat tjera që lidhen me procesin mësimor. Nuk kemi të bëjmë me krahasime të suksesit të nxënësve me vitet apo periudhat e mëhershme ku vërehet një rënie edhe e suksesit si gjatë vitit shkollor po ashtu edhe në testin e maturës dhe arritshmërisë kur rreth 49% e nxënësve nuk e kanë kaluar testin e maturës, dhe këto rezultate flasin për rënie të kualitetit të arsimit dhe kjo është mjaft brengosëse që tregon se në DKA ka një jo profesionalizëm total.

Linda Shahini, u tha se janë pranuar militantët e partive e nëse do të ishte ashtu do të duhej të isha punësuar edhe unë për shkak se e kam mbaruar një pjesë të shkollimit në Amerikë dhe e njoh mirë gjuhën angleze.

Nehat Tërpeza, replikoj me Nazmi Krasniqin për të cilin tha se e ka sakatosur arsimin më së tepërmi. Pastaj përmendi disa dëme të cilat i ka shkaktuar arsimit në Komunën e Lipjanit.

Nazmi Krasniqi, kundër replikë tha se Nehati aq sa din aq flet dhe më herët kemi plotësu vendet e punës sepse nuk kemi pasur kuadro profesionale, ndërsa tash ka raste kur kemi kuadro dhe sistemohen njerëz jo profesional.

Ali Stublla, Nehati tha se janë përfunduar rrethojat por unë e di se në shkollën fillore Ilmajl Luma rrethoja është mbet në gjysmë. Pastaj tha se pikojnë kulmet nëpër disa shkolla, e qështje tjetër është edhe bartja e personave me aftësi të kufizuar.

Labinot Shahini, kjo qështje u politizua shumë dhe shpesh po kalon në qështje personale. Cilësia në arsim është breng e të gjitha niveleve të shkollimit dhe jo vetëm në Komunën tonë dhe cilësia nuk ngrihet dhe bije mbrenda një viti por duhen disa vite.

Testi i maturës për bindjen time nuk është fare korrekt sepse ka pasur kopjime. Konkursët janë qështje që duhet të trajtohen.

Blerim Gashi, disa prej gjërave që dashta t'i them i tha Labi, por suksesi i nxënësve varet nga shumë faktor. Cilësia dhe suksesi nuk varet vetëm nga stafi i DKA-së por ka ngecje në shumë hallka organizative. Do t'i lus të gjithë për depolitizim të shkollave sepse jemi politizuar shtëpërmi. Kjo administratë kur ka filluar punën është hequr klasa e 13-të dhe ky problem është trashëgu, por një gjë gëzon se të gjithë punëtorët që punojnë marrin paga. E kam një vërejtje për qështjen e kabineteve shkollore nëpër shkollat fillore dhe të mesme.

Rënia e suksesit në testin e maturës ka ndodhur për shkak të ngritjes së kujdesit për mos kopjeim e jo për shkak të rënjes së kualitetit të mësimi.

Xhevat Olluri, mendoj se qështja e arsimit kërkon vëmendje të veçantë. Arsimi nuk është mirë askund në Kosovë e po ashtu edhe te ne por jo me fajn e DKA-së por me fajn e të gjithë neve. Cilësia ka rënë sepse nxënësit nuk i dinë gjërat elementare siqë janë thyesat e gjëra tjera. Pastaj pyeti se kur do të filloj punën gjimnazi në objektin e ri.

Në vazhdim tha se numri i nxënësve serb nuk pasqyrohet në statistika, e gjithashtu dha kompliment për pagesën e punëtorëve arsimor dhe shtoi se në disa lëmi punojnë punëtorë jo adekuat si për shembull lëndën e astronomisë e jep gjeografi i cili nuk ka thirrjen adekuate. Shembull më i mirë i punës së keqe është ekonomia e shkollës ku derisa kanë punuar profesionistët kemi gjendjen shumë të mirë e tash ajo është mjerim.

Ramiz Qirriqi, tha se a dojna me i ru nxënësit apo pushtetin. Në vitet e kaluara një njeri që është tani këtu në sallë e ka nxjerr një test ja ka dhënë djalit të vet dhe ai e ka kaluar

testin pa problem por ka edhe të mira në arsimin tonë p.sh. kanë zënë vendin e parë në garën e informatikës.

Rasim Hasani, unë nuk do të përmendi emrin dhe gjëra tjera, por nuk është mirë të merremi me dezinformata. Këto po i bëjnë njeëzit që përmes pushtetit kanë pasur benificione për veti e jo pse ja kanë dertin arsimin.

Veshja e punëtorëve arsimor kemi mjaft vërejtje por këtu e kemi aprovuar Rregulloren e kodit të veshjes.

Pastërtia nuk është në nivel por shumica e punëtorëve teknik janë të moshuar dhe nëse ata i largojmë do të keqëkuptohemi.

Trajnimet janë bërë dhe po bëhen në vazhdimësi.

Sa u përket konkurseve deri sa për vite me radhë nuk ka pasur konkurse si p.sh. konkurset e lehonisë ndërsa tani janë 25 konkurse të lehonisë e po ashtu edhe pas pensionimit të arsimtarëve.

Kriteret e konkurseve janë të precizuara me Ligj por kemi raste kur për kundër kualifikimit nuk kanë aftësi për kryerjen e profesionit.

Helmimi në shkolla që u ngrit si qështje nuk qëndron.

Në Gjimnaz dhe në shkollën Profesionale kemi stër ngarkim të klasëve me nxënës.

Tabelat krahasuese nuk i kemi bërë sepse nuk i kemi përgatitur. Grupe e mësimdhënësve të cilët e kanë nxjerr testin jasht dhe ju kanë ndihmuar nxënësve për të kopjuar, ndërsa na nuk jemi të interesuar për këto veprime.

Sa i përket nxënësve serb ne nuk kemi të dhënat të sakta as për numrin e nxënësve as për suksesin e tyre.

Te ekonomia e shkollës profesionale ne e dijmë që gjendja nuk është e mirë prej shkuarjes së menaxheve Norvegjez.

Florent Hoxha, Drejtori nuk mund ta pranoj se ka pasur tendenca politike në pranim të kuadrove e si me thënë ndryshe kur ju leni profesionistin e pranoni dikin që nuk është kuadër përkatës.

Pastaj tha se na trego pse vende të lira të punës, ju i shpallni si zëvendësime. Ne nuk e kemi vetëm shqetësimin politik po vërtet ka shkelje sepse na jemi pjesë e këtij realiteti dhe po na dhemb.

Testi i maturës ka rënje edhe pse po i njeiti staf ka qenë organizator i testit.

Në fund tha se ka plot lëndë në gjykatë për shkeljet që i keni bërë.

Ali Stublla, heqja e shpenzimeve për nxënësit me aftësi të kufizuara lirisht po them se edhe këtu ka shkelje drastike.

Te pastërtia në Gjimnaz dhe “Adem Gllavica” nuk mund të mbahet me këta punëtorë dhe jo për fajin e tyre por për shkak të kushteve.

Daut Azemi, nuk e di a e ka pa Drejtori shkollën e re “Nezë Bujani”, edhe pse ajo shkollë është e re, ajo nuk i plotëson kushtet për mbajtje e procesit mësimor. Ka plot lshkelje që kanë bërë më herët ku një arsimtare në Babush i ka pasur edhe dy asistene.

Nazmi Krasniqi, unë mendoj që duhet të shikohet stafi i DKA-së ku ka jo profesionalizëm.

Shkolla e Plitkoviqit ende nuk ka filluar të punoj edhe pse jemi në nëntor.

Shkolla e Qendrës Korrektuese është dashtë të ruhet vazhdimësia e saj.

Vlora Limani-Hajnuni, u etiketova për qështjen e vjehrrit tim i cili është zgjedhur Drejtor i shkollës në Dobrajë por ai është profesor shumëvjeçar i historisë dhe është qertifikuar për Drejtor në kohën kur Nazi ka qenë Drejtor i DKA-së dhe po ju siguroj se për këtë qështje asnjëherë nuk kam insistuar me ndikimin tim te Drejtori i DKA-së.

Në vitin 2008 janë bërë shkelje edhe të procedurave ligjore sepse janë zgjedhur njerëzë të pa kualifikuar.

Rasim Hasani, është nivel i ulët të diskutohet për vendin e lirë dhe vendi i rezervuar.

Qysh nuk i ka ardhur keq Florent Hoxhes e ka dhënë Tik-un ose vëllau tjetër student ka punuar si asistent.

Shkolla “Adem Gllavica” nuk është keq vetëm qe një vit por ajo gjendje ka qenë qe shumë vite dhe kostoja e renovimit të kësaj shkolle është shumë e madhe.

Gjendja e shkollës në Bujan është e tillë për shkak të pa përgjegjësisë së njërit prej asambleistëve në këtë sallë.

Çështja e pusit në oborrin e shkollës “Vllëzërit Frashëri” është mjaft e komplikuar sepse ai pus është hap pa procedurë të rregullt të prokurimit vetëm me kërkesë të ish Drejtorit të arsimit.

Në Dobrajë është zgjedhur Drejtor një njeri që ka qenë edhe më heret Drejtor.

Për Plitkoviq ne kemi insistu që nxënësit e këtyre familjeve të barten në shkollë në Vrellë ose në Gadime, por për shkak të kushteve të terrenit nuk është e mundur të bëhet transporti. Ai punëtorë që ka punuar aty me vite të tëra tani me e larguar është jo e ndershme për neve.

Qendra Korrektuese është pa legjislacion konkret sepse nuk ka Ligj me të cilin rregullohet forma e qertifikatës e cila do t'i lëshohej nxënësit që ka vijuar mësimet në atë shkollë. Aty është një numër i vogël i nxënësve ndërsa me vendim të inspektoratit kërkohet që për qdo lëndë mësimore të caktohet mësimdhënësi adekuat profesional gjë që bartë një kosto mjaft të lartë financiare.

Florent Hoxha, - replik nuk jam këtu as për kërcënime as për fyerje por forca e argumenteve është në anën tonë. Unë i përmenda me emëra e mbiemëra dhe pozicione faktet e shkeljeve gjatë pranimi të kuadrit arsimor.

Ali Stublla, në faqën ku shkruan për transportin e nxënësve me aftësi të kufizuara ka shkelje. Më vonë fillojnë një debat i ashpër në mes të Daut Azemit dhe Ali Stubllës dhe Kryesuesja dha pauzë për konsultime me shefat e grupeve parlamentare.

Pas konsultimeve me shefat e grupeve parlamentare për shkak të gjendjes së krijuar Kuvendi vendosi që pika e 8-të të shtyhet për mbledhjen e radhës e gjithashtu pas votimit me 25 vota për u vendos që kjo mbledhje të përfundoj.

Mbledhja përfundoi në ora 16,³⁰

***Ekstraktin e hartoi
Sami Murati***

***Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni***